



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-043

Prishtinë, më 13 dhjetor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 13 DHJETOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit,

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica,

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca,

Nga: OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe tre pika shtesë, të cilën i miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 dhjetor 2011,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 dhjetor 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 dhjetor 2011, u miratua pa vërejtjes.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet të martën, më 20 dhjetor 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësi organike,
5. Shqyrtimi i parë i Projektkodit penal i Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Arkivat,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Parkun Kombëtar "Sharri",
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna",
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deminimin humanitar,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas,

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të huajt,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Azilin,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës,
16. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore,
17. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për liritë fetare në Kosovë.

Po ashtu, Kryesia vendosi që të plotësohet rendi i ditës, për mbledhjen plenare të datës 20 dhjetor 2011, me të gjitha pikatë që i plotësojnë kushtet për shqyrtim sipas Rregullores së Kuvendit.

Pikatë shtesë:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës

Kryesia, Projektligjin e cekur më lartë, e radhiti në rend dite për shqyrtim, për mbledhjen plenare që do të mbahet më 20 dhjetor 2011.

2. Njoftimi me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë të disa neneve të Ligjit Nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Kryesia, pasi u njoftua me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 14 paragrafi 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit Nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, mori këtë

P Ë R F U N D I M

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë të nenit 14 paragrafi 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit i dërgohet Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputetëve të Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës, për njoftim.

3. Njoftimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për skadim mandati të dy gjyqtarëve

Kryesia, pasi u njoftua lidhur me skadimin e mandati të dy gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryetari i Kuvendit, në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, do të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për emërimin e dy gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:30** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.